

Lirika



Germa dashurie

Llambro
G. Ruci





Llambro Ruci, ka lindur më 1946 në Dhërmi të Vlorës. Ka mbaruar Politeknikumin «7 Nëndori» në Tiranë dhe deri në vitin 1971 ka punuar në Hidrocentralin, «J. V. Stalin» të Bisticës. Tani është student në degën e gazetarisë të USHT.

Ka botuar vëllimet poetike «Jam elektricist» (1967) dhe «Vij nga bregdeti» (1970). shkrime të ndryshme publicistikë dhe një sërë tregimesh fantastiko-shkencorë pér fëmijë, etj.

Ky është libri i tij i tretë.

844-1

RPI

LLAMERO G. RUCI

Germa Dashurie

Lirika



SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

Redaktor: RAMAZAN VOZGA

Piktori: SAFO MARKO

Tirazhi 2000 kopje Format 70x100/32 Stash: 2204-72

Shtyp. Drejtoria Qendrore Poligrafike
Shtypshkronja «8 NENTORI» — Tiranë, 1973

GERMA DASHURIE

Ylberet pas shiut i kam dashuruar, por s'i kam
 prekur dot;
detin e kaltër e kam çarë me pash, nuk arrita t'i gjej
 fundin;
diellin e kam ndjekur me sy qëkur lind gjer perëndon,
s'munda asnjëherë ta mbaj mbi supe;

erën e kam ndjerë veshur e zhveshur në gryka e
 hapësira,
si mund ta mbash erën në pëllëmbë?
Frutave të tokës ua njoh shijen, jam i ngopur me to;

të gjitha m'i solle Ti,
5 gérma dashurie:

P a r t i !

I pëshpërisin fëmijët e doçkat mbi globin e ëndrrave
ulin,
e timpanin e zemrës vënë në hapat e diellit;
njerzit me sy i përkëdhelin dhe pemët e gjëzimeve
zgjaten, zgjaten
dhe ditët ikin më shpejt,
e stinët piqen më shpejt!

Të kam parë dhe të kam takuar gjithë jetën midis
njerëzve.

1971

B U T R I N T

ty Lavda

Midis kolonave tē amfiteatrit u ndalem: tē ngréna
nga era e uji,
si drurë tē djegur nga rrufetë.

Mure gjysém tē rrëzuar nga pesha e kohës. Mbësh-
tesim sytë tanë
dhe ato dridhen...

Mbase kujtojnë rininë e tyre,
ndofta mjekrën e Ali Pashait nën harkun e breshë-
rive tē topave.
si një cfurk i zjarrtë ngulur në ijet e perandorisë.

Pusi i virgjëreshave me buzë tē brejtura nga litarët
e shtëmbave.

Hapat e kumbimit, majë gishtrinjve, vinë rrötull
nesh
me meloditë mjergullore tē fyejve, që tundin degët
e dafinave
(tē gjelbra, tē gjelbra ato rriten brënda nesh!)

e përmes tyre një heshtë e mprehtë si gishti tregues
midis buzëve,
si përcjellja e nuseve, larg qëmoti nga nënët në Jug.
Ku veni moj korba?
si rruga për në dhe të huaj përmes një rrebeshi të zi.

Eshtë e largët historia
po ne e ndjejmë rritjen, transformimin brënda vetes...

Prekim gurët.
Nën to filli i legjendave, si peri i ballonave të fëmi-
jëve,
na shpëte tek Dea.
«Zonjë shtëpie dil në prag
të presish të porsaardhurit.
Urdhëro të ndezin zjarr, të bien trompetat e gëzimeve
dhe vajzat të sjellin lule!»

Ky është Butrinti. I rëndë si gurët e kalasë,
që kanë zënë vend pranë portës së luanit,
si një pjesë e përfytyrimit për këtë kafshë-simbol
të trimërisë,
i lehtë si ky mozaik, ku pasqyrohen dantellat e
pemëve,
qetësia e barit dhe velat e briri i artë i alarmit,
mbështetur në ballin e agimit.

Flasim dhe jehona e zërave kthehet prapsht. Mos
vallë

nuk dimë të shqiptojmë qartë gjuhën tonë?
Jo mos u tremb, këtu akustika e kohës është e qartë.

Dëgjon e dashur, sa herë të flasësh, ndalu të dëgjosh
jehonën!

1972

STUDENTËT KËPUTËN TËRË DEGËT E VJESHTËS

Këputëm tërë degët e vjeshtës
në mëngjezet e lagur të stërvitjes.

S'jemi indianë lëkurëkuq,
që kërkojnië skalpet e fitores a gjahun e madh,
po ushtarë si gjithë ushtarët
që nxjerrin bajonetat përpara në mjegull e baltë.

Qerpikët e vajzave u lagën nga vesa e dëllinjave,
vajzat në pushim këlkojnë lule vjollce.

Në ndodhtë që këto kodra rreptë të gjëmojnë
nën kosat e harbuara të krismave,
edhe atëhere s'do harrojmë
lulet që na mblohdhën shoqet.

1972

THIRRJA E NJË VAJZE

mbi një varr të vjetër

O udhëtar, hidhmë një tufë me të qeshura,
kur sytë i shtie në pllakën time kalimthi,
dhe hijen e qiparizit rrëzoma në mesditë!

Unë doja të vrisja kryqet e drunjtë të heshtjes,
por ata papritmas krisën
e më mbuluan këtu një ndajnatë.

Krismat i mbaj dhe tani në bark
siç mbartin të tjerë brejtjet e ndërgjegjes.

1972

R I C O S -it

Unë belbëzoj në gjuhën tënde,
kalin e vargut shaloj, të kuqin,
të arrij Prillin:

Gjeta bukën e të qeshurën,
një krehër për baluket e fëmijëve me vijë
të drejtë anash
(të mëdhenjtë kanë qenë të vegjël njëherë!)

Prillin tënd kërkova pas vjershave:
«Është tharë, më thanë parqet bosh
dhe rrugicat e kyçura në shi;
po ne presim Alekon e Petron,
po ne presim teto Lenin të ndërrojë fustanin e zi».

Brengën s'e lidh dot si dem për brirësh;
çdo zinxhir e bren ajo, e ikën,
piqet me merakun e xha Miços,
karafila mbjell në lehe zemrash:

Þér Alekon e Þetron
që do vinë me bukën e të qeshurën,
me krehërin pér baluket e fëmijëve.

1) Alekua, Petrua, teto Leni e xha Miçua janë heronj revolucionarë të poezive të Jani Ricosit.

ERA PERANDOR

«*Të bijtë e Himarës që s'falin as mikun,
e si mund ta lenë gjallë armikun?
si s'marrkan dot gjak me pushkët bes-
nike?
ka shenjë më të bukur se zemrën ar-
mike?»*

BAJRON

Tej dritareve dikush më tregonte malet.
Mbrëmja shoi ngjyrat, emrat;
në njolla i ktheu tiparet e rrugëtarëve.

Sonte simbylla sy.
Dihaste uji, pemët dhe lisi i kujtimeve shumë
tavolinën më mbuloi me degë:
breznish

Iliaz Pasha¹⁾ u ndal para hijeve të fëmijërisë
dhe u tha zogje — «ndalni këngën»,
dhe u thirri reve — «shëët!
të gjëmojë daullja turke!»

E rrudhi tokën inati i Sulltan Sulejmanit²⁾
derdhur me hekurin e nxehtë
të perandorisë së Njëmijë e një Qyteteve.

Gjak në pragun e shtëpive,
te shtatë burimet,
në radhën e mullirit
(fëmijët prisnin bukë e magjet haheshin për brumë!)
Dhe në Litharicë rridhnin si përrenj dollitë,
topat ngjatjetonin bejtet e Haxhi Sheretit.³⁾
Reshti i të internuarve nga Ali Veziri
u ngjitej bejteve si shënim redaktori,
të dëbuarit si brazdë trishtimi.
Emra. Emra që shkelën dhe u shkelën:
u shkrinë e s'dihet ku vanë,
u bënë pluhur, nga ranë?

Era perandor mbi perandorë i fshiu të gjithë.
Por njerëzit e këtij vendi mbetën e mbetën

te shpella e Bukuries, në një stan a nën një lis,
ku u ulën për t'u çlodhur pas luftrash, pas dertesh.
Vetëm e vetëm.

1972

-
- 1) Iliaz Pasha — gjeneral turk që kryesoi një ekspeditë kundër Himarës.
 - 2) Sultan Sulejmani, «i madhërishtë» erdhë më 1537:
 - 3) Haxhi Shereti — poet i oborrit të Ali Pashës.

KËNGA E BARIT

Shiun që ra
toka e piu me një frymë,
(si një rrufitje kafeje në udhëtim dimëror.)
Dhe bari në valle
kërcellin e gjelbër
tund në mënyrë triumfale:

I plotfuqishëm jam.
Ngjitem kudo: mbi kulmet e gërmadhave gjer
majë çative.
Me erën luftoj, më erën tallem,
zot i tokave të djerra,
zbres të pushtoj tokat e zeza;
më shkulin përsëri,
por unë prapë shfaqem nën një limon, nën një
ulli.

Vetëm duart e njerëzve më arrijnë.
Unë mbuloj gjithëçka,
ato më mbulojnë mua.

DHËRMIU NË BREG TË DETIT

Zambak i bardhë mbi shkëmb të rreptë,
rrënjet në zemër të një copë toke fort ç'i paske
ngulur ti,
dheun grushte grushte mbledhur si flori.

Ndërruan stina e shkuan mote,
buzë këngëve që shkumbëzojnë erë pjeshke e
erë kripe,
si një ëndërr gjëmimkaltër zgjatesh, rri.

Fshatari kasketën kthen mënjanë
e diellin e vështron në sy,
kap një degë portokalle,
tund një varg limonash.
Dashuria rrjedh si lëng i rubintë,
begatia skuget në lëkurë kokrrash.

1972

Da e këtë që nuk është më i përgjithshëm
Për çfarë që është që do t'i përcaktoj
Të vjen një dëgjimi i rëndësishëm

E ka që e përditëse që vjen vështira e shpërbluese
Nëpërmjet vështirës së vjetës së fundit, që vjen me
Vështira e shpërbluese. MIRIGJARDEHË

KUR HESHT HIDROCENTRALI

E ka që vjen vështira e shpërbluese. MIRIGJARDEHË

Maqinat fërshëllen për herë të fundit, dritat u
mekën; u këputën yjet:

as krisma, as zhurmë, përpëlitet vigani i zënë në grackën e avarisë.

E puthura u përgjysmuat, zhveshën stolat, e qara e Lolës u pre me sytë zgjatur mbi globin e ftohtë: do vijë dielli?

Kafeja e teto Kandës u vderdhet. Të gjithë mbi trubinë përkulemi. Ku të dhëmb, moj? Vetëm njëri urdhëron. Hej luftë!

Përtë parën herë një servil harroi t'i buzëqeshë drejtorit.

1971 BIBLIOTERA E SHTETIT.

GJIPORASTER

N° INV.

61422

30215

MIRËSEARDHJE

Kaloj mbi shteg sikur shkel mbi pergamenën e kronikave. Zëri i tyre i largët mezi arrin nga shekulli i dytë të dhjetë, kur vinin mbi gjemi perandoreshat bizantine të merrnin kripë e diell në këto brigje dhe lanë pas vetëm emrin e këtij vendi «mbretëror».*)

Vetmja, me një dryn të ndryshkur, në kishën e Shën Stefanit sikur përgjon shpinën e njerëzve.

Era gërvish faqet e afreskeve dhe kalimtarin e rastit e mban për xhakete:

«Qëndro dhe pak këtu, unë di aq gjëra për ata që u kam prekur fytyrën e gjoksin, u kam pushtuar tërë trupin.

Brejta maja heshtash e pancirë çeliku ardhur që nga Normandia e nga Brusa...» C’te bëjë kalimtari? Mban këmbët për një çast dhe kthen shpinën.

Tani nē këtë vend zbresin njerëz tē zakonshëm
(asnjë titull s'mbajnë e shpura s'i përcjell!)
me pluhurin e rrugës mbi supe,
me veshje tē lehtë e vështrimin e hedhur larg:
«Zotër tē dikurshëm nën ndryshkun e harrimit,
mos u dëshpërohi; se trompetat e mirëseardhjes s'bien më pér ju...
ndryshe rreh pér neve era,
ndryshe këngën merr ky deti blu.»

Në Rivierë dritharet dhe dyert rrinë hapur dykanatësh.

*) Ky vend ndodhet në Dhërmi afér kampit tē punëto-rëve e, sipas gojëdhënavë, ka qënë plazh perandorak bizantinas.

ÇAST NË VARRET E DËSHMORËVE TË SARANDËS

Nikos

...Mbani vesh hapat e gjelbëra të pranverës.
që po zurret këto shkallë të gurta...

5 Maj.

Si një pikë e blertë në rreshtin e gjatë
ngjitet këtu e dashura e skulptorit,
e pyet ajo relievin e bardhë:
si unë qënkeshin partizanet?!

1970

DASHURIA IME

Një ullishte shtrihet nën dritaren time
në Bregun e Detit:

Ka agrume e mollë, o ç'flutura vërtiten në sytë
e mi,
kur shtëmbën e lumturisë kthej
dhe gllënkat e mëdha të dashurisë pi i etur me
të fejuarën time
gji më gji e buzë më buzë.

Të gjitha ç'kam jetës ia jap,
që dashurinë pa prerë
të ma kthejë
dhe tokën time punoj thellë e më thellë.

1971

Ç'TË JETË VALLË, Ç'TË JETË?

Qytetit të rinisë sime.

Sa herë vij në Sarandë, më pushton një shqetësim
i ëmbël!

Ç'të jetë vallë, ç'të jetë?

Dashuria për shokët a për detin,
jehona e viteve apo takimet e papritura,
këto drita —kërpudha që shkrijnë muzgun
midis netëve, shtëpive, njerëzve?

Rekëtimat e kujtimeve më ndjekin
tek shkallët e këtij qyteti amfiteatër,
kapur pas jelevë të malit
me shinat paralele të ditëve dhe apartamenteve.

Më ka dehur sonte aroma e kripës,
dashuria për këta njerëz, që i njoh fytyrë për fytyrë

(ua di zërin, hapat);
ky gaz vajzash si gu-gu pullumbash
kur ndeh tërë qënjen time
të kap të qeshurën e së dashurës.

Sarandë, vetëm tri rrugë të shkurtëra të lidhin.
Por me shumë shkallë,
që hypin e zbresin në zemrat e njerëzve,
poshtë dritareve, që i gufon deti,
si vela në lundrim e sipër drejt diellit.

Sa herë vij këtu më bymehet çdo qelizë e trupit
dhe e gëzimit tim
dhe ngrihem në këmbë kaq i madh e kaq transpa-
rent,
i ngjashëm me gjithçka që më rrethon.

1971

BIR FSHATARI

Rritës portokallesh është im atë,
nën duart e tij epen kurorat e pemëve:
është më vështirë të krasitësh agrume,
apo krahët e mendimeve?

Mora me vete
kthjelltësinë e ujrave që shkumëzojnë si valle
labësh,
që zgjaten e afrohen fluturimthi
nën harqet prej dëbore të fustanellave;
prekjen e flokëve, rrudhat;
atë vështrim, o sa të gjatë e të merakosur të
nënave,
që u thinjën aq shpejt nga bora e pritjeve!

Dhe kudo, ku ndalova, e ndjeva veten para këtij
imazhi
aq të vogël,
aq të dobët
sa ç'është një shkëmb në bregun e hapësirave.

Hapa fshatarësh dua të kumbojnë në këto këngë
dhe gazi i vajzave degë më degë si lauresha.
Unë në këtë tokë kam hedhur rrënje
i fortë si këta breza.

1971

MIRUPAFSHIM

Duhet të them diçka dhe të kyç në mendje
shtegun e ardhjes,
dhomën tonë prej beqarësh me dy-tre fotografi
e ca revista
dhe bufenë e kantjerit, si një shilars qetësie
varur mbi lumë,
ku folëm fjalë të thjeshta
e pamë diellin e shpresave
të na ulej në tavolinë si një njeri i zemrës.

Shokë, ja dhe dy fjalët e ndarjes:
ju dua siç jini,
të ashpër dhe në përkëdhelje...

1972

INICIALE MBI PEJSAZHIN DIMËROR

Maqina lëkundet e rënkon kthesave të Llogorasë,
si të dehurit i merren këmbët,
horizonti i qullur kullon në dritare.

Pikat rrjedhin në sytë e xhamtë të autobuzit
si lotët e miliona dashurive të papërfunduara,
që enden nëpër botë
e i thith toka;

në brymën e xhamit
shënojmë inicialet tanë e qeshim.

1972

DASHURI E GJELBËR

Jam këtu midis bisqeve
dhe dashurinë time ua jap bimëve e njerëzve.
Natyrën dhe veten i dua përherë në rritje,
në përsosje;
nuk ngopem me ato që krijuan e krijova,
me ç'ka më dhanë e ç'mora,
megjithëse jam në çdo gjë që prekni:
në to lëvrin
o gjaku im,
o ëndërra ime.

Lodhje nuk ndjej, unë punonjësi i tokës,
krijuesi i fryshtës së dashurit, që gjymtyrëve bimore,
i fjalëve të thëna e të pathëna për to;
unë që transformoj motin dhe stinëve u vë emrat që
pëlqej
(gjejini në xhepat e agronomëve!)
E në se më kini parë me fytyrë të ashpër diku,

mos harroni, si çdo fytyrë e ashpër
kam më tepër dhëmshuri se gjithë fjalëbutët
për trupat e bukur të pemëve, luleve e sythave:

Duaje ujin, sintezën e blerimit, kanalet. Mos përto
— përvish pantallonat, llërët...
shoqërisht po të drejtohem: mos vidh orët, kohrat,
gëzimin e botës
ose
mos i vrit me duar e me fjalë!

1972

MOS U PIKËLLO SONTE

Erdhën në park punëtorët e komunales,
vjeshtën e ngarkuan në karroca
dhe e shpunë mespërmes njerëzve,
jashtë qytetit.

Pemët mërdhijnë
dhe rrugët pullalie mbledhin erë.

Ti mos u pikëllo sonte:
studentët e panë pranverën në brigjet e liqenit,
e priten në shkallët e Universitetit...

1972

BLERIMI I LULESHITËSES

Në këndin e luleve ulen stinët, bukuritë,
vijnë djem e vajza, plaka me shami,
përmbi ngjyrat lenë dëshirat, sytë
dhe pranverën marrin nëpër shporta.

Midis luleve, më e bukura ti, Blerta
që blerimin dhomave shpërndan:
për lulet, a për ty
vijnë djem e vajza në dyqan?

Rrugës Blerta del e lulet i kërkon.
(rriten, rriten drurët jeshil të rinisë!)
Karafilat këmbanat e kuqe tundin në ballkon
dhe ta bëjnë me sy: do vish?

1972

NE KËTË VEND...

Në këtë vend ku gjelbërimi i afrohet një hap rëre detit
dhe gojëdhanat përcjellin kampin e Jul Qezarit tej
maleve Akrokeraune,
i harruar nga të gjitha ç'lashë pas,
larg të gjithëve u ndala.
Mendimet e mi të blertë
bulëzojnë degë më degë.

Mbush grushtet me ujë dhe me një lumturi të virgjër
dëgjoj zërat e tokës, zëra që u folën edhe të tjerëve.

Dashuria ime bashkon tri kohët e foljeve
dhe punon si një hamall i urtë vetëm me të ardhmen.
Nuk dua të hutohem, në këto brigje të përgjysmoj
dashurinë midis natyrës, që krijon vetë,
dhe njeriut që e korigjon vazhdimisht gjer tek ngjyrat
e drita.

Nxitoj njëqindfish
me detyrën, që flet edhe mes harresës së gjelbër,
këtu në «Taborin» e Ali Pashës, ku ish dikur një kullë
e bukur pushimi
dhe vajzat e zgjedhura të krahinës me valle e këngë
kënaqnin miqtë
(kaq mbajnë mend pleqtë, se uji i fshiu rrënojat
e mbi ta tanë rëndojnë pjergullat, pjeshkët dhe
ullinjtë).

Dhërmi më 1972

ME GRUSHTIN LART

Një vogëlushe, 7-8 vjeç, u tha armiqve, duke i kujtuar partizanët: «Vdekje Fashizmit». Barbarët shtinë përmbi të... .

Kapërxeve shtigjet

si një thëllëzë e vogël e trembur nga krismat.
botën përshëndete me grushtin e njomë ngritur lart.
bri gërshtave të zeza e këmborëve që të ndiqnin pas:
«Vdekje Fashizmit»!

Por përshëndetjen tënde me plumba e përshkuan
bishat,
e nga grushti yt lulëkuqet përdhe ranë,
me përrenj të tjerë gjaku ato
që nga malet kudo u shpërndanë.

Partizani plak kur dëgjoi heshti...
mbi shënjestër iu varën të thinjurat mustaqe.
Dhe komisari për të parën herë
harroi t'u mbante konferencë partizanëve.
Lulëkuqet e tua grusht më grusht kaluan si trakte,
ashtu si ballët me fishekë xhepave të luftëtarëve.

Dhe përgjigjen gjëmimet e partisë ta sollën
zemër më zemër, shtëpi më shtëpi:
«Liri popullit!»
me këtë fashë të zjarrtë plagën ta mbështollën
që përsëri me grushtin lart lirinë të përshëndetje ti.

1970

SHIU NË KORRIK

Erdh befas shiu kaq i pritur.
Vajzat ngelën në çezmë me shtëmbat në duar:
«shi-shi bo-bo shi.»
E artë fëmijëri!

U lagen fustanet e holla,
gjoksi i njomë kërcen nën këmishën e bardhe.
«Korba ku do vemi,
çdo na thotë nëna?»

E qeshën dhe i ngacmuan djemtë
në bufenë verore në lumë.
Shiut i thanë: «bjerë e lagna,
se vreshtat e lulet duan ujë!»

1972

NJËZET DIEJ E NJËZET VERA

Njëzet diej e njëzet vera ranë e të mbuluan trupin
si një hardhi hape degët,
kish ardhur koha e lulëzimit.

Dhe të thanë mos me gishtin në buzë,
dhe të thanë mos me gishtin në tëmth.

Ti ndënje shumë net pa gjumë
e shumë ditë i lage me lotë.

Kur kapërceu dielli i njëzetë trupin tënd,
nëpër mjergullën e butë tiranase, një zë i thellë
të thërriste.

Një tren, duke kaluar nxitimthi ndanë jush,
fërshëlleu gjatë, gjatë
dhe ndezi semaforët jeshilë të ditëve.

HOP, HOP!

Unë u bëra burrë e mushka u plak.
Të përpjetat që mirrte me hov,
me zor i ngjit e dihat:
hop, hop, Murga jonë!

Tring-tring tund qafën ajo
e syrin e madh më ngul.

Eh, Murga jonë, u plake dhë ti,
kurrizi t'u zhvesh e t'u thinj.
Tund kokën ngadalë, çdo thuash e di,
do vijë radha ime, do vijë.

Vitet do më thinjin dhe mua
e flokët do m'i marrin vërtetë.
Por në këngët e ardhme me shpirt të ri
do ngjitem pa ngurime e dihatje si ti.

1972

JERASIMOS

kushtim

Të gjitha pikuan nga peneli yt nervoz
që vërtitet
si një gjeneral mbi planin e betejës:
portokallet dhe vajzat,
që mbledhin në përparëse buzëqeshjen e vjeshtës,
rëra e bardhë, si një çarçaf dashurie të kthjellët...

Veç firmën nguron ta hedhësh në fund,
piktor, q'le pa thënë?

1971

SHIU I MADH

Bishtat e bubullimave shuhen midis fjalëve të nënave,
që presin fëmijët te porta,
rrebeshi me kamzhikë të ujtë rreh hapësirat —
kullon qelli i ngrysur mbi fytyrat e kalimtarëve.

Vetëm para fëmijëve shiu u ndal papritmas
mbi lulet e çadrave.

1970

SHOKUT TIM POET...

Dička tē pathënë tē themi;
ja pse rrimë pagjumë e mendjen vrasim si
Arkimedi,
ja pse vërtitemi rrugëve pa zhurmë
me planin e qyteteve tanë imagjinarë...

e bota na quajnë hutaqë,
e vajzat s'na shohin ndër sy!

Ndaj le tē nxijmë fletoret më pak,
me njerëzit tē rrimë më shumë e tē qeshim.
Pse tē strukemi vetëm në park
kur me tē dashurën mund tē vemi aty?

E kokën hënore trishtimit t'ia presim,
e diellit t'i flasim: pa jakë ti, diell
tē themi dy fjalë,
tē bëjmë dashuri!

VIJAT E MBASDITES

Ja në këtë orë të dashuruarit
lënë pikëpjekje nën kupolat e gjelbërimit dhe
dritareve të hapura,
gostisin njëritjetrin me pasta e akullore
dhe puthen shpejt e shpejt mes fjalëve.

Ne...

me një kuptim e shqetësim më të gjerë,
për kohën dhe dashurinë,
u ulëm në bangat e shkollës së mbrëmjes:
dhe shtymë shumë takime për të nesërmen,
e hoqëm shumë vija mbi puthjet, shëtitjet.

Botë e madhe mos na kthe krahët!
Megjithëse vonë po vimë,
mbi duar, që u fërkuan e u zhveshën mes metaleve,
do të shpiem edhe ne mes njerëzve dashurinë.

1972

MË PRESIN

Shokut tim, Kristaqit.

Unë, i çmobilizuari,
kësaj mbrëmje të gjatë nuk di q'të marr:

Fjalët e komandantit, që mat pulsin e netëve në
alarme
me vështrimin e merakosur,
mbërthyer atje në vijën e kufirit,
duart e shokëve,
me të cilët u ndodha aq herë pranë vdekjes,
aq fort pranë jetës...

Pas krahëve të mi mbeti posta jonë e bardhë mes
maleve
si rrufepritëse për stuhitë,
balta e kuqe e luginës,
që e thërmuam me gishtërinj

duke nuhatur aromën e bukës, flladin e grunjërave
dhe hapin e përgjysmuar të shkelësit.

Do iki larg.

Më pret Jugu, e dashura, dritat
por i çmobilizuar s'do jem kurrë:
çdo mëngjes si mbërtheja njëherë xhaketën
kopsis mallëngjimin dhe krenarinë
si qytetar, ushtar i RPSH.

1970

PËR BLERIMIN

Dritat, mbrëmjeve të fshatit,
i presim si diellin çdo mëngjez.
Dhe elektriçistit i tundim grushtin
kur kalon ora tetë.

Koha jonë me sakrifica:
Pikë, pikë bie uji në rrënjet e agrumeve.
Për blerimin
ujë, ujë le të rrjedhë drita!

1972

«V E T È T I M A»

Duke përshkuar vendlindjen e lulëzuar me portokalle
e limonë
takova kudo njerëz të rinj,
që merren përditë me tokën e pushkët,
kultivimin e ndërgjegjes dhe bimëve;
që shkulin «timen» e «tënden» nga gjokset e gjërë
siç heqin nga dheu i ullinjve
barërat e këqia me gjithë rrënje:

duke kënduar këngën e tyre më të dashur —
«Zaho Koka, xhevahiri,
në ballë të digjet ylli!»

E këndoijnë me gjithë zemër
himariotët dhe labët atë këngë
për ushtarin e mirë të partisë, «Vetëtimën»,
dhe shtrëngojnë tok grushtet e rëndë

mbi kujtimin e komisarit,
që e këputi nga rruga një krismë...
Dhe nënët sjellin ndër mend...
Nënët që lufta i gjeti në kopësht.
S'arriten të mbledhin kokrrat
dhe fëmijëve t'u shpien frutat.
Gërmuan thellë, i shkulën pemët
e qëndruan me armë në dorë pranë burrave e bijve;
gatuan grushtin e fundit me miell,
arnuan këmishë,

plagë trupi e plagë zemre

dhe ruajtën në trupat e ngrohtë të fëmijëve
farërat e së nesërmes për diellin dhe pemët.
Në çdo 5 Maj,
me harqe të bardha lulëdhensh e dafina,
lapidarın freskojnë fëmijtë e Himarës.
I këputin atje larg buzë maleve
që përshkonte më këmbë heroi mes plumbave, gur më
gur
nga Komiteti Qarkor në zemrën e popullit,
duke shpënë përmes rrugëve të pashtuara të kohës
të nesërmen e tokës, ujrave dhe brezave.

Duke përshkuar vendlindjen e lulëzuar me portokalle
e limonë
takova kudo njerëz të rinj,

që përditë merren me pushkët e kopshtet.
Në buzë e në duar u gufon prilli
tek këndoijnë këngën e tyre më të dashur:
«Zaho Koka xhevahiri, në ballë të digjet ylli!»

1970

VAJZA E VALAVE

«Ju té bukur zoqj,
té ju kam një shpresë.
ju që çani dete, male,
dua t'u pyes...»

Kjo këngë, si kujtim i zisë, në begatinë e stinëve me grurë, më bën té mendoj, té mos harroj nënënat dhe vendlindjen.

E u hedh përsipër këto fjälë nga një pemë e dashurisë së tyre.

Tek ky shkëmb ish lidhur varka e mërgimtarit;
litari i saj do zgjatej e do përdridhej në qafën e vatrave
me tendosjen e ndarjes për së gjalli:

pesë gishta quell,
një grusht dhe
e qindra shami té zeza nderur në pritje,
té fryra nga briri i xha Dhosit, varkarit;
drejt jugperëndimit té moskthimit.

Dhe emrat e të ikurve
merrnin kuptimin e toponimeve.
Emrat si krah zogu çanin Saharanë e mërgimit.

Vajzat venin e vinin nga kopshtet e brinjat
me një bukuri epike që s'guxoje ta prekje,
me një «mirëdita» të prerë nga nxitimi.
Ditëve ku flinte pulsi ynë
e netëve shuk nën velenxat e brejtura nga koha
gurgullonte thirrja e jetës
dhe mbinin dy karafila të mëdhenj gjaku:
do vijë i dashuri im?
do vijë babai im?

Zërat e tyre dua të rrok,
tek rrëmoj me mundim duke ngjyer duart
në tokën e ngrohtë
dhe prek erërat që krisën zemrat si trarët e çatisë,
prek shpatullat e lagura të vajzave,
heshtjen e tyre sypërdhe
në brengën që s'e tret dheu:
«Gjithë bota venë e vinë,
po ai nuk vjen!»

S H O K E T

Fytyrën e çdo shoku e ruaj midis relikeve të zemrës
në nyje gjaku,

Jemi larg por s'vonoj t'u tregoj të rejat e t'i pyes për
gjithë ato,

që ne i quajmë gjëra të zakonshme...

E kur të lodhur kthehen,
nxitoj me vështrimin tim të butë
të them atë që s'thonë fjalët.

Ndodh që notoj në pellgun e sentimentalizmit,
gjithëcka e përkohshme më mbështjell.

O, atëhere zëri i shokëve dhe pëllëmbët
e grushti i tyre
më zgjojnë nga ajo trullosje e turbullt e thyerjes nga
jeta,
si tek tregimi për Kolomin thirrja: tokë, tokë!

JOLES QE RITET BUZE BISTRICËS

TELEFONI

Fluturuan trenat e fëmijërisë,
kërcimet e arushave trompetjere,
ato i mori Ermira e vogël në botën e saj tingëllonjëse.

Ti tani, midis numërave,
kërkon babin në telefon:

«Dëgjon, babi, dëgjon?
Sot ne mësuam gërmën V.

Ç'u thashë zogjve, që cicërinin në gushën e pranverës
dhe xha Gogos, që më mori hopa përbimi degët e
unë e shkrova me një frymë:

Emrin e xhaxhi Enverit me shkronja të mëdha
dhe përbri vura emrin tim,
dëgjon, babi? Jo-la!»

VJESHTA DHE NE

Vjeshta hyri në bisedën tonë
me ujin e turbullt,
me mërmëritjet funebre të gjethive të thara
që vërtiten
mes gishtërinjve të erërave.

Papritmas dielli i plotë ra kokëposhtë në liqen,
plepat si zebra të harbuara turfulluan me gëzim:
në i rrëzuam tok gjethet e fundit të trishtimit,
në të sapodashuruarve sa telashe na hap kjo stinë!

1971

DHOMA JONË NUMËR 53

Dhoma jonë e vogël, bota aq e madhe...
hyjnë e dalin poetë, dashuri dhe seminare.

Liqeni karshi, si buzëqeshjet e vajzave,
gjokset na përshkon.
Dhe bie shqetësimi ynë
mbi fletoren e vjershave natën vonë.

1971

PASQYRA E LËNDËS

	Faqe
Gërma dashurie	3
Butrint	5
Studentët këputën tërë degët e vjeshtës	8
Thirrja e një vajze	9
Ricosit	10
Era perandor	12
Kënga e barit	15
Dhërmiu në breg të detit	16
Kur hesht hidrocentrali	17
Mirëseardhje	18
Çast në varret e dëshmorëve të Sarandës	20
Dashuria ime	21
C'të jetë vallë, c'të jetë?	22
Bir fshatari	24
Mirupafshim	26
Iniciale mbi pejsazhin dimëror	27
Dashuri e gjelbër	28
Mos u pikëllo sonte	30
Blerimi i luleshitëses	31
Në këtë vend...	32
Me grushtin lart	34
Shiu në korrik	36
Njëzet diej e njëzet vera	37
Hop, hop!	38
Jerasimos	39

Faqe

Shiu i madh	40
Shokut tim poet	41
Vijat e mbasdites	42
Më presin	43
Për blerimin	45
Vetëtima	46
Vajza e valave	49
Shokët	51
Jolës që rritet buzë Bistricës	52
Vjeshta dhe ne	53
Dhomë jouë numër 53	54